



RAPORT PERFORMANCE NË ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE & TRAINIMIN ONLINE NË KLSH...

**ECURIA E PROCESIT TË TRAJNIMEVE NË
DISTANCË, GJATË PERIUDHËS
16 MARS - 16 PRILL 2020**

RAPORT PERFORMANCE NË ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE & TRAJNIMIN ONLINE NË KLSH...

ECURIA E PROCESIT TË TRAJNIMEVE NË DISTANCË (ON LINE)

RESUME:

Përgjatë periudhës **4-javore 16 mars - 16 Prill 2020**, nga gjithë audituesit e KLSH-së është zbatuar dhe avancuar teknika e Edukimit në Distancë, ose Trajnimi Online, në kushtet që audituesit nuk janë të pranishëm fizikisht në auditor apo salla leksionesh, **diktuar dhe kushtëzuar nga situata e jashtëzakonshme e pandemisë globale nga shpërthimi i Coronavirusit COVID-19.**

Metodologjia trajnuese është aplikuar me sukses nëpërmjet nxitjes së nervit të angazhimit dhe vullnetit të gjithë kolegëve për ndjekjen rigoroze të trajnimeve në këtë kohë të stresit nga kjo situatë, pasi në çdo aspekt kjo është e dobishme për një jetë aktive intelektuale dhe profesionale. Përmes kësaj pakete trajnimi online harmonizohet impenjimi dhe vetëangazhimi, me të mësuarit nga platformat elektronike, sipas një programi të larmishëm 4-javor, me module të strukturuar, të konsoliduara dhe aprovuara me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 145/3, datë 16.03.2020, si Platformë e Trajnimit në Distancë.

Moto-ja që ka shoqëruar këtë proces trajnimi në vijimësi është:



KONTROLLI
I LARTË I
SHTETIT

- Për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, trajnimet si elemente të kualifikimit profesional, janë jo thjeshtë e vetëm një indikator për vlerësimin e performancës 6-mujore dhe vjetore të çdo punonjësi, por edhe një **Standard Auditimi i njohur, i pranuar dhe i detyrueshëm** për zbatim.
- Në **Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022**, nënvizohet domosdoshmëria e forcimit të sistemit të strukturuar të edukimit profesional, nëpërmjet certifikimit të audituesve publikë dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ku thuhet se:

“Mbështetur në ISSAI 200 – “Standardet e Përgjithshme të Auditimit” sipas të cilit “... SAI duhet të adoptojnë për të zhvilluar dhe trajnuar punonjësit e tyre për t’i aftësuar ata të kryejnë detyrën e tyre efektivisht dhe për të përcaktuar bazat për avancimin profesional të audituesve dhe te stafit tjetër...”, KLSH e konsideron trajnimin dhe zhvillimin profesional të audituesve si një standard auditimi. Audituesit e jashtëm të sektorit publik duhet të jenë të aftë t’i përgjigjen ndryshimeve të ambientit ekonomik, social, teknologjik dhe të ballafaqohen me standardet në rritje, jo vetëm të aktivitetit auditues, por edhe të përballen me presione politike e publike apo sfida të tjera që lidhen me vetë vulnerabilitetin e profesionit të auditimit.”

- Nevoja për trajnim është **pjesë e pandarë e koshiencës së një audituesi të ditur**, e cila në analizë të fundit përkthehet në kompetencë profesionale të shtuar dhe në rritjen e produktivitetit të gjithsecilit në KLSH.

2.FOKUSI, TARGET GROUPI DHE PERFITIMET.

- I. Trajnimi i periudhës 16 mars - 16 prill 2020 është konceptuar dhe organizuar nëpërmjet ndarjes së stafit të audituesve të KLSH në 4 grupe si vijon:
 - *Grupi i parë*: audituesit me formim akademik në financë, kontabilitet, ekonomi, administrim biznesi etj.
 - *Grupi i dytë*: audituesit me formim akademik në shkencat inxhinierike, juridik, shkenca sociale etj.

- *Grupi i tretë:* audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës,
- *Grupi i katërt:* audituesit e Departamentit të Auditimit të IT-së.

II. Tre platformat (Grupi I & II, Grupi III dhe Grupi IV) kanë sintetizuar nga katër module secila, të ndjekura në mënyrë interaktive, duke siguruar një përvojë të re trajnimi rezultative dhe efektive.

III. Arsyet përse u aplikua dhe po përdoret teknika e trajnimit online në kuadër të edukimit të vijueshëm të audituesve të KLSH-së:

- Gjithçka është kushtëzuar nga situata e jashtëzakonshme, e shkaktuar nga pandemia e COVID-19, ndaj për një situatë të pazakonëshme kërkohen masa të jashtëzakonëshme, nënvizojnë udhëheqësit e IFAC.
- Mënyrë më efektive dhe pa kosto, realizuar njëkohshëm, duke shfrytëzuar dhe fituar kohë në një proces kualifikimi, ndërsa jemi në kushte e izolimit dhe respektojmë rigorozisht urdhëresat e veçimit dhe distancimit shoqëror.
- Kjo zgjidhje trajnimi plotësisht online, ndihmon në konsolidimin e njohurive ekzistuese dhe shtimin e njohurive të reja, që mund të studiohen nga shtëpia me shtrirje në kohën e gjithë secilit.
- Burimet e literaturës në dispozicion ofrojnë udhëzime të qarta dhe koncize për të kuptuar kuadrin e integruar të standardeve, rregulloren e procedurave të auditimit, manualët, dhe procesin e auditimit.
- Mbështetje e asistencë nga Sektori i IT në internet dhe asistencë për teste apo ushtrime që kërkojnë asistim.
- Metodologjia e zhvillimit të trajnimit është rishikuar plotësisht dhe po përqendrohet kryesisht në funksion të promovimit dhe përafrimit të trajnimit me praktikën më të mira dhe në përputhje me paketën e re të Standardeve Profesionale të INTOSAI (Kuadri i Integruar IFPP) dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.
- Literatura dhe modulet teorike e multimediale sot njihen dhe aplikohen gjerësisht e në mënyrë dinamike në të gjithë botën profesionale, ndaj po implementohen nëpërmjet studimeve të

rasteve praktike, si një informacion i vlefshëm dhe i dobishëm.

- Trajnimi teorik po harmonizohet me kontekste specifike ushtrimore për të mbuluar tema të tilla si risku i auditimit, dobësitë në shkrimin e raportit të auditimit, llogaritja e materialitetit, aplikimi i testeve thelbësore dhe substanciale, kalkulimi i risqeve të zbulimit dhe raporti me parregullsitë materiale, etj.

Audienca e synuar: gjithë audituesit nga departamentet e auditimit apo drejtoritë e tjera në institucionin e KLSH-së, janë përfshirë si pjesë e studimit në këtë paketë **studimi inovativ** të çështjeve nëpërmjet internetit, ku audituesve u kërkohet të konceptojnë dhe formulojnë opinionet, përgjigjet dhe zgjidhjet mbi një nomenklaturë të gjetjeve apo rekomandimeve në një mjedis të simuluar të auditimit, në funksion të zbërthimit e shtjellimit të çështjeve që rrjedhin nga literatura që është ofruar më parë.

IV. SUPORTI NGA IT DHE REFLEKTIMIM I NDRYSHIMEVE NË SIMMPA/ REVZONE

Në funksion të ndjekjes dhe pasqyrimin të trajnimeve online si mundësi alternative e ndarjes dhe shkëmbimit të ideve, u modifikuan dhe përmirësuan opsionet e reja programore si vijon, në:

- Web-faqen e KLSH-së, nëpërmjet shtimit në panelin “Informacione”, tek grupi “Trajnime”, zërin “Trajnimet Online”.
- Programin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe Mbështetjen e Proceseve të Auditimit (SIMMPA / RevZone), të dritares/ opsionit “Trajnimet Online”.
- Hartimit të udhëzimit mbi përdorimin e manualit të Trajnimeve (nga Sektori IT)
- Hedhja në Revzonë e ecurisë së ndjekjes së trajnimeve të zhvilluara nga çdo auditues (Matrica e ndjekjes së ecurisë Mars-Prill 2020), Informacioni i plotë mbi trajnimet (Raport Progreset javore dhe të përditësuara); postimi i fondit të testeve, pyetjeve, ushtrimeve dhe rasteve studimore, etj.

V. SKICIMI I KURSIT TRAJNUES NE DISTANCE

Me përmbajtje interaktive dhe gjithëpërfshirëse, aktivitete vlerësuese, studime të rasteve dhe literatuire e metodologji didaktike mbështetëse, Programi Online i Trajnimit të Audituesve të KLSH-së është hartuar në

përputhje me udhëzimet e përshkruara në praktikat bashkëkohore; dhe synon t'u sigurojë audituesve të KLSH njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tipologjitë themelore të auditimit- aftësi që kërkohen për të iniciuar, udhëhequr dhe raportuar me sukses një auditim të përputhshmërisë financiar, të IT apo performancës, si dhe të zhvillojnë aftësitë e komunikimit të kërkuara për një auditim sipas Standardeve.

Përmes **webinareve, detyrave, diskutimeve të individualizuara apo të grupuara në nivel Departamenti/ Drejtorie Auditimi, ky cikël trajnimesh online ka përfshirë një gamë TEMASH, të tilla si:**

- standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me planifikimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm;
- hapat e planifikimit të angazhimit dhe auditimi i bazuar në rrezik;
- vlerësimi i rrezikut dhe materialiteti;
- përgjegjësitë e audituesit për identifikimin e mashtrimit në auditimet financiare;
- kontrollin dhe sigurimin e cilësisë sipas fazave të auditimit;
- shkrimi i raporteve të auditimit bazuar në letrat e punës dhe dokumentet e tjera suportuese të angazhimit, në përputhje me Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

Parimi bazë “*Experientia Mutua Omnibus Prodest,/ "Mutual experience benefits all"*, ka udhëhequr procesin 4-javor të ndarjes dhe shkëmbimit të njohurive online nëpërmjet trajnimit. Me synimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, etapat e trajnimit online janë udhëhequr nga lajtmotivi:

**📄 Askush nuk i di të gjitha,
📄 Të gjithë dinë diçka,
📄 Të gjithë janë pjesëmarrës dhe
📄 Secili anëtar i ekipit është një burim i identifikuar origjinal dhe kontribues.**

MATERIALET E SHPËRNDARA SIPAS JAVËVE.

Referuar e-maileve të dërguar me datën 18 dhe 19 Mars 2020 për gjithë audituesit, nga Kryetari i KLSH dhe Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, si

dhe ne vijim me datat 23 Mars 2020, 29 Mars 2020 dhe 6 Prill 2020 (për Grupin e I dhe II), janë përfshirë: materiale të ndryshme e të larmishme trajnuese, (që nga prezantime në ppt, rastet studimore; ushtrime e teste me alternativa, literatura të rekomanduara dhe të inkurajuara, linqe për hulumtim të literaturës, etj., që për 4 Modulet e ndjekura kanë përfshirë:

Grupi I & II

JAVA I	JAVA II	JAVA III
<p>I. Standartet Ndërkombëtare të Auditimit: Pjesa e Parë dhe e dytë Roli dhe përgjegjshmëria e auditimit. pavaresia, etika dhe cilësia në Auditimin e Jashtëm Publik.</p> <p>Literatura</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Botimi “Standartet Ndërkombëtare të Auditimit”, : KLSH, Tiranë, 2016. 2. www.intosai.org 3. Leksione prezantuese në <i>power point</i> mbi kuadrin e praktikave profesionale ndërkombëtare të INTOSAI-t,nga Q.Cibaku. <p>Leksione prezantuese në <i>power point</i> mbi rolin dhe përgjegjshmërinë e auditimit, referuar praktikave profesionale ndërkombëtare të INTOSAI-t ,nga prezantimet në KLSH.</p> <p>II. Kuadri i Integruar i Standardeve Profesionale 2020</p> <p>Literatura</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Botimi “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”, : KLSH, Tiranë, 2016. 2.INTOSAI Framework of Professional Pronouncements (IFPP) https://www.intosai.org/fileadmin/downloads/focus_areas/audit_standards/INTOSAI_Professional_Pronouncements.pdf 	<p>I. Roli i SAI-t në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar.</p> <p>Literatura</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Manuali udhëzues i KLSH për hetimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit, miratuar nga Kryetari KLSH me vendimin nr.80, date 30.6.2018 2. Leksione prezantuese në power point mbi manualin e KLSH per auditimin e mashtrimeve financiare dhe korrupsionit, pergatitur nga Q.Cibaku. 3.Botimi: The role of supreme audit institutions in fighting corruption, autor Marie Chêne https://www.u4.no/publications/the-role-of-supreme-audit-institutions-in-fighting-corruption.pdf 4. Manuali INTOSAIT, KLSH ne praktike. 5.Botimi special: Fraud & Corruption/ Ethics & Integrity, Journal 2/2019, Gjykata Evropiane e Auditimit https://www.eca.europa.eu/lists/eca_documents/journal19_02/journal19_02.pdf 	<p>I.Auditimi i Përputhshmërisë Parimet e ketij auditimi, kriteret dhe karakteristikat e ketyre kriterëve, siguria (e arsyeshme dhe e kufizuar), planifikimi i auditimit e, te kuptuarit e kontrollit te brendshëm, materialiteti, vleresimi i riskut, elementet e vleresimit te riskut, evidence e auditimit, modeli i sigurise, mbledhja dhe vleresimi i evidencave. Komunikimi Rezultateve / Raportimi dhe ndjekja e rekomandimeve : Përgatitja e Projekt raportit të Auditimit Procedurat kundërshtuese/ komentet nga subjektet e audituar Raporti Përfundimtar i Auditimit Sigurimi dhe kontrolli i cilesise Ndjekja e Rekomandimeve</p> <p>Literatura</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Manuali i Auditimit Përputhshmërisë, KLSH, dhjetor 2015 2.Rregullorja e Procedurave te Auditimit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.107, datë 08.08.2017

		<p>3.Manuali i auditimit te prokurimit publik, miratuar me: Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 249, datë 28.12.2018 Tirane 2019,</p> <p>4.Botimi i KLSH “Raportimi i auditimit”,me autor Gj. Ndrejaj, Tiranë 2013</p> <p>5.Leksione prezantuese në power point mbi auditimin e perputhshmerise pergatitur nga E. Elezi.</p>
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Praktikuar dhe zgjidhur rastet studimore të përcaktuara, dërguar me email pranë Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit ✓ Konsultimi dhe përvetësimi i materialeve sipas linkeve me video dhe në versionin word dhe powerpoint ✓ Konsultuar individualisht videot ilustruese në youtube 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Praktikuar dhe zgjidhur rastet studimore të përcaktuara, dërguar me email pranë Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit ✓ Konsultimi dhe përvetësimi i materialeve sipas linkeve me video dhe në versionin word dhe powerpoint ✓ Konsultuar individualisht videot ilustruese në youtube 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Praktikuar dhe zgjidhur rastet studimore të përcaktuara, dërguar me email pranë Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit ✓ Konsultimi dhe përvetësimi i materialeve sipas linkeve me video dhe në versionin word dhe powerpoint ✓ Konsultuar individualisht videot ilustruese në youtube
JAVA IV		
<p>Auditimi Financiar dhe rregullorja e procedurave të Auditimit: 6 raste studimore per shtjellim</p>		

Grupi III:

Aktivizimi i vazhdueshëm i audituesve të Departamentit të Auditimit të Performancës në hulumtimin, studimin e literaturës, manualeve të auditimit të performancës dhe raporteve më të mira që mund të shërbejnë si model, duke ezuruar në masë të plotë temat e projektuara të modulit specifik departamental dhe zgjidhur rastet studimore e testet e kërkuara. Më konkretisht, gjatë periudhës 10 Mars – 20 Prill 2020, stafi i dept. të auditimit të performancës, duke punuar në kushtet e shtëpisë, u angazhua në trajnimet e mëposhtëme:

Fusha e trajnimit	Tema specifike	Literatura
<i>Java 1 – 16.03-20.03</i>		

Standardet ndërkombëtare të auditimit	Klasa e parë dhe e dytë e standardeve	ISSAI 1, ISSAI 10-40
Manuali i auditimit të performancës	Mandati dhe fushëveprimi i auditimit të performancës	Ligji 154/2014, Kreu 1 & 2 i manualit
<i>Java 2 – 23.03-27.03</i>		
Standardet ndërkombëtare të auditimit	Klasa e tretë dhe e katërt e standardeve	ISSAI 100, 300, 3000, 3100 dhe 3200
Manuali i auditimit të performancës	Planifikimi në auditim	Kreu 3 & 4 i manualit
<i>Java 3 – 30.03-03.04</i>		
Manuali i auditimit të performancës	Teknikat e auditimit dhe komunikimit	Kreu 5, 6 & 7 i manualit; Research methodology
<i>Java 4 – 06.04-10.04</i>		
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	Lidhja e objektivave me strategjitë zhvillimore në Shqipëri	SKZHI, SKMS, SKE, SKT, SPA, etj.
<i>Java 5 – 13.04-17.04</i>		
Indikatorët e Performancës	Indikatorët e monetarizimit të 3E-ve	“Indikatorët e matjes së performancës sipas eksperiencës britanike”

Për sa më lartë, audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës u testuan me dt. 13.04.2020, për njohuritë e përfituara. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, audituesit janë angazhuar në pëkthime materialesh, përgatitjen për konferencë, përmirësimin e manualeve, etj.

Grupi IV:

Nga ana e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit janë ezuruar në masë të plotë temat e projektuara të modulit, si vijon:

Tema e trajnimit

<p>"Teknikat e auditimit me ndihmën e kompjuterit"</p> <p>01 Introduction to IDEA Data Analysis video 5:35" by Case Ware 02 Introduction to IDEA Data Analysis "Importing data" video 13:34" by Case Ware 03 "Joins files in Idea", video 14:59 minuta by Scripting and more www.ideascripting.com 04 Introduction to IDEA Data Analysis "Extracting data" video 5:35" by Case Ware 05 Introduction to IDEA Data Analysis "Duplicate Key Detection" video 3:45 by Scripting and more www.ideascripting.com 06 "Import Data with Import Assistant" video 6:33" by Case Ware 07 "Importing an Excel File" video 3:05" by Scripting and more www.ideascripting.com 08 "Importing an PDF File" video 9:03" 09 Introduction to IDEA Data Analysis "Categorizing data" video 8:12" by Case Ware 10 Introduction to IDEA Data Analysis 1. Punimi i materialit të kërkuar. 2. Konsultimi i literaturës se rekomanduar. 3. Kryerja e shembjeve dhe zgjidhja e rasteve studimore. 3 "Creating, modifying and removing fields" by Case Ware video 8:53" by Case Ware 11 "Duplikate Key Exclusion" video 2:32" by Scripting and more www.ideascripting.com</p>	<p>"Përcaktimi i rasteve me risk përmes algoritmit të krijuar për CUBE"</p> <p>Shpjegues i përcaktimit të rasteve me risk Raste studimore 1. BioEconomy 2. GAO-19-609 3. GAO-19-636 4. GAO-19-712T 5. PenaltiesByPolice 6. StartBusiness</p>	<p>"Rëndësia e analizimit të të dhënave në auditim"</p>	<p>"3 raste studimore ne fushën e auditimit IT"</p> <p>1. Rast studimor mbi DRC 2. Rast studimor mbi Sigurinë fizike 3. Rast studimor mbi sigurine e informacionit Literatura: - Manuali i auditimit të teknologjisë së informacionit. - Manualit Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit - Rregullore mbi ndërtimin e dhomave të serverave.</p>	<p>"Sistemi i Informacionit për Mbështetjen dhe Menaxhimin e Procesit të Auditimit"</p> <p>1. Manual i përdoruesit SIMPA 2. - Politika e Sigurisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit 3. - Rregullore e funksionimit të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Proceseve të Auditimit dhe Administrative (revzone)në Kontrollin e Lartë të Shtetit.</p>	<p>Leximi literature:letrare, profesionale, historike</p>
--	--	---	--	---	---

Java IV:


Ushtrim demonstrues dhe aplikativ: Hartimi i planit te auditimit per:

1. Posta Shqiptare
- 2.Arshiva Qendrore
3. OSHEE

Kanë realizuar detyrat e përcaktuara të gjithë audituesit e Departamentit të Auditimit IT, më saktësisht kryerjen e:

- Analizës së riskut me Manualin aktiv të teknologjisë së informacionit për gjenerimin e matricave te auditimit dhe grafikun perkates;
- Hartimin e:-shkreses per fillim auditimi; programin e auditimin, memon per projektin e auditimit si dhe ndarja e detyrave.

FONDI I TESTEVE DHE MATERIALEVE TE REKOMANDUARA DHE SHPERNDARA GJATE 4 JAVEVE, MBI “ARTIN E AUDITIMIT PUBLIK” :



Teste dhe rastet e studimit të dërguara audituesve për zgjidhje:

Grupi I & II:

Data e dërgimit të fondit të testeve	Java :	Teste për tu zhvilluar në mënyrë të individualizuar	Linqet e rekomanduara për literaturë suplementare
9/3/2020	I	3 RST + 19 ushtrime e teste	2 linqe
23/3/2020	II	3 RST + 10 ushtrime e teste	5 linqe
29/3/2020	III	3 RST + 25 ushtrime e teste	12 linqe
6/4/2020	IV	6 RST + 15 ushtrime e teste	2 linqe
		15 RST + 69 ushtrime e teste	21 linqe

Grupi III:

Data e dërgimit të fondit të testeve	Java :	Teste për tu zhvilluar në mënyrë të individualizuar	Linqet e rekomanduara për literaturë suplementare
vazhdimisht	I-IV	Kontroll i njohurive/ testim me dt. 13.04.2020, për njohuritë e përfituara	

Grupi IV:

Data e dërgimit të fondit të testeve	Java :	Teste për tu zhvilluar në mënyrë të individualizuar	Linqet e rekomanduara për literaturë suplementare
vazhdimisht	I-IV	10 RST 21 Raste me zgjedhje	10 linqe

KONTRIBUTET DHE PËRGJIGJET E AUDITUESVE MBI USHTRIMET & TESTET E SHPËRNDARA NGA DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT:

Konstatohet një rekord reagimesh nga audituesit e KLSH, nëpërmjet kthimit të përgjigjeve me e-mail mbi ushtrimet, testet e zgjidhura dhe

rastet studimore të analizuara dhe të shpjeguara si duhen trajtuar dhe zgjidhur.

Në shkallë institucioni rezulton se

- Kanë ndjekur në mënyrë të plotë gjithë modulet e trajnimit 4 javor 152 auditues të KLSH-së.
- Janë angazhuar me përgatitjen e temave për Konferencën Shkencore 11 drejtues dhe auditues të institucionit.
- Nuk kanë mundur të regjistrojnë gjithë modulet dhe nuk kanë ndjekur akordin e shlyerjes së detyrave për zgjidhjen e testeve e rasteve të studimit dhe kthimit të përgjigjeve zyrtare deri në fund të datës 22 prill 2020, gjithsej 22 auditues nga 152, ose 13 % me këtë shpërndarje sipas Departamenteve:

NR	DEPARTAMENTI	GJITHESAJ PUNONJES	NUK KANE NDJEKUR PAKETEN E PLOTE:
1.	Dep.Auditimit të Buxhetit	21	1 auditues
2.	Dep.Auditimit të Institucioneve Qëndrore	23	4 auditues
3.	Dep. Auditimit të Performancës	25	0
4.	Dep.Auditimit të Vetqeverisje Vendore	24	4 auditues
5.	Dep.Auditimit Shoqërive Publike& Investimeve të huaja	23	5 auditues
6.	Dep.Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	15	2 auditues
7.	Dep.Auditimit të IT	13	0
8.	Dep.Juridik	6	4 auditues

9.	Dep. Metodologjis e, Standardeve dhe Sig. Cilesise	8	1 auditues
10.	Drejtoria e AB	3	1 auditues
	Përmbledhur	161	22

ASPEKTE PORCEDURIALE TË PËRLLOGARITJES SË FONDIT KOHOR NË TRAJNIMIN ONLINE:

- Me datën 2 Prill 2020, në zbatim të porosisë së Kryetarit të KLSH u është ndarë informacioni mbi ecurinë gjithë audituesve dhe drejtuesve të KLSH-së, Raporti Pjesor mbi Ndjekjen e Trajnimeve ne Distance ku është tërhequr vëmendja për mos anagazhim konstant nga të gjithë kolegët auditues.
- Gjithë raportet pjesore të ecurisë dhe ndjekjes së trajnimeve online në nivel institucional dhe individual janë hedhur në sistemin Rev Zonë, në zbatim të përcaktimeve të pikës nr.4, të Urdhrit të Kryetarit të KLSH me nr. 43, datë 02.04.2020, “Për hedhjen në Rev Zonë të dokumenteve të auditimit”
- Deri në datën 17 prill 2020 janë hedhur nga audituesit materialet në Revzonë nga ku janë krijuar 22 rekorde në zërin “Trajnimet online”.

Katalogu i Trajnimeve është publikimi i parë dhe përmban të gjitha modulet e ofruar nga KLSH për trajnimin e zhvilluar gjatë periudhës 16 Mars-16 Prill 2020.

Materiali i trajnimeve është realizuar në një periudhë 4 javore dhe është konsideruar 4 ditë në javë, ose 16 ditë për gjithë periudhën e vlerësuar, kur:

- Janë konsultuar të gjithë materialet që janë dërguar;
- Përgjigjet e plota e të sakta të kazuseve, rasteve ushtrimore, pyetjeve studimore, etj si dhe kur
- Materialet e trajnimit janë pasqyruar në dritaren respektive “Trajnimet e mia”, në Programin SIMMPA/RevZonë.

Për audituesit që nuk kanë plotësuar dhe dërguar gjithë modulet në mënyrë të plotë, ose që kanë dërguar përgjigje të pasakta dhe të pa arsyeuara, ky numër ditësh **zbret 2,5 -3 ditë/javë**


Ky proces trajnimi në distancë ka synuar angazhimin dhe ngritjen e nivelit të angazhimit të audituesve publikë në një situatë jo të zakonëshme, për t'iu përgjigjur nevojave të reja të auditimit.

Për herë të parë u punua **një numër rekord temash dhe ushtrimesh praktike e rastesh aplikative e studimore**. Kështu që, ky katalog i përgatitur në këtë situatë jo normale, do të plotësohet gradualisht duke marrë në konsideratë tema të reja. Organizmi i çdo moduli është bërë ose sipas formës së planit ekzistues të trajnimit, të miratuar në fillim të procesit nga Kryetari i KLSH dhe një shtojce/ suplementi për javën e fundit të tij, që reflekton disa materiale që KLSH ka akumuluar për sesionet e trajnimit, por që janë shoqëruar me tema dhe aspekte të këndvështrimeve të reja, pasi janë zhvilluar tema relevante për çdo modul – me idenë për të qenë fleksibël për t'iu përshtatur nevojave të trajnimit në distancë (online).

Gjithë trajnimi, është synuar përcjellja në mënyrën me të mirë të mundshme, e ekspertizave dhe të ofruarit e përmbajtjeve cilësore për çdo gjë që i duhet një procesi që nuk zhvillohet në klasë, me rreze shtrirje njohurisë rreth kuadrit ligjor dhe standardeve profesionale dhe adoptimit të praktikave më të mira profesionale.

INDIKATORET E PERFORMANCES SË TRAJNIMIT

(METRIKSET E TRAJNIMIT) :

 Në fund të periudhës 4 javore (10 - 16 ditore për efekt trajnimi), konstatohet se janë realizuar këto tregues të rezultateve:

- **Kanë ndjekur procesin e trajnimit online 152 auditues duke konsultuar dhe studiuar materialet e dërguara dhe duke zgjidhur dhe dërguar testet, ushtrimet dhe rastet e studimit (obligime të detyrueshme trajnuese për stafin auditues), duke plotësuar kriteret e përfshirjes dhe regjistrimit të trajnimit në distance, sipas rregullave të pëcaktuara më para nga Titullari i Institucionit.**

- **Realizuar: Ditë mesatare trajnimi për auditues:
11,27 ditë/auditues**

Pjesëmarrja: Unike!

Siç shikohet dhe nga matrica përkatëse e pjesëmarrjes dhe angazhimit për studimin e materialeve të përgatitura për Tre Modulet e para të këtij

sesioni, kontributi në zgjidhjen dhe dërgimin me posten elektronike (e-mail) të ushtrimeve, testeve dhe rasteve të studimit, nuk është bërë për çdo modul dhe nga të gjithë audituesit brenda javës përkatëse. Ky është kriter bazë, që do të shërbejë për regjistrimin dhe njohjen e ditëve të trajnimit të vijueshëm profesional për çdo auditues.

- I. Kanë vijuar punën për përgatitjen e temave dhe materialeve në funksion të Konferencës së ardhshme Shkencore 11 drejtues dhe Kryeauditues;**
- II. Kanë vijuar punën për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vijueshmërisë së procesit të trajnimeve gjithë drejtuesit e lartë të institucionit dhe drejtorët e departamenteve/drejtorive sipas fushës që mbulojnë.**
- III. Java me rezultatet më të lartë në regjistrimin e kontributeve të audituesve për trajnimin në distancë është 30 mars-4 prill që lidhet me ndjekjen e modulit nr. 3.**
- IV. Ka kontribuar në përgatitjen e materialeve trajnimit: Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, si dhe me angazhimin e veçantë të Z.Q.Cibaku, Z.R.Muça dhe Z.K.Kondakçiu.**

NDJEKJA E TRAJNIMEVE ALTERNATIVE ONLINE, KRAHAS ATIJ TE DETYRUAR

📄 Ndjekja e kursit ne distance nga **znj.Aulona Jonuzi** pranë Shoqatës se Kontabilistëve të Certifikuar ACCA Londër.

📄 Pjesëmarrja ne seminarin e organizuar online ne datat 7-8 prill 2020, nga Grupi i Punës se EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit, me temë "Energjia e Qendrushme". Në këtë seminar bazuar ne vendimin e Kryetarit morën pjesë, Dejtori i Departamentit të Auditimit **Z. Bajram Lamaj** dhe auditueset **znj.Ermira Vojka e znj.Eva Kasmi**.

📄 Nga Departamenti i Auditimit të IT, **znj. Elsona Papadhima** ka ndjekur online në kuadër të zhvillimit profesional trajnimet e mëposhtme::

1. Certifikimi "Comptia Security+" - përfunduar ne 06.04.2020 (19 ore trajnim + Certificate)
2. "Who's In Your Cloud? How Privileged Access Controls are Leaving You Exposed" - Trajnim 1 ore nga ISACA 07.04.2020 (certificate pjesëmarrje)
3. "Unbury Yourself from the Deluge of Data with Next Generation Information Protection" Trajnim 1 ore nga ISACA 16.04.2020 (certificate pjesëmarrje)
4. "Managing 3rd Party Risk with COBIT" - Trajnim 1 ore nga ISACA 17.04.2020 (certificate pjesëmarrje)

📄 **Z.Aldo Kita** ka ndjekur online në kuadër të zhvillimit profesional trajnimet / takimet e mëposhtme:

- Future of Data Protection, Privacy & IT Risk Management 2020! (Organizuar nga ISACA)
- CCENT ICND 1100-101 course" (*trajnim online Geek-University, marrë certificate përkatëse*)

ANGAZHIMET E NJEKOHËSHME GJATË PERIUDHËS SË DISTANCIMIT SOCIAL NGA CONID-19, PER PERMIRESIMIN E MANUALEVE, RREGULLORES DHE GUIDAVE TE AUDITIMIT:

Vendimi/ Urdhri i Kryetarit të KLSH (Nr, datë)	Subjekti	Grupi i punës
Urdhër nr. 44 , Datë 31.03.2020	Për përditësimin dhe përmirësimin e manualeve të auditimit të performancës, Auditimit të Buxhetit, Auditimit Financiar dhe Auditimit të Pajtushmërisë	Manuali i Auditimit të Buxhetit: M.Naço, Gj.Preci, V.Gaxhaj, J.Goce, K.Ngjela.
Urdhër nr. 44 , Datë 31.03.2020	Për përditësimin dhe përmirësimin e manualeve të auditimit të performancës, Auditimit të Buxhetit, Auditimit Financiar dhe Auditimit të Pajtushmërisë	Manuali i Auditimit të Performancës: R.Muça, E.Vojka, M.Misini M.Kurushi
Urdhër nr. 44 , Datë 31.03.2020	Për përditësimin dhe përmirësimin e manualeve të auditimit të performancës, Auditimit të Buxhetit, Auditimit Financiar dhe Auditimit të Pajtushmërisë	Manuali i Auditimit Financiar: A.Jonuzi, B.Zeqiri, E.Hoxha, H.Solis, B.Shkurti

<p>Urdhër nr. 44, Datë 31.03.2020</p>	<p>Për përditësimin dhe përmirësimin e manualeve të auditimit të performancës, Auditimit të Buxhetit, Auditimit Financiar dhe Auditimit të Pajtuëshmërisë</p>	<p>Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë:</p> <p>L.Nano, Q.Cibaku, M.Haxhija, E.Elezi</p>
<p>Urdhër nr. 45, Datë 31.03.2020</p>	<p>Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe Regjistrin Institucional të zbatimit të rekomandimeve</p>	<p>Manuali i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve:</p> <p>L.Nano, Gj.Preci, N.Nako, A.Kita, A.Kume, E.Papadhima</p>
<p>Urdhër nr. 46, Datë 31.03.2020</p>	<p>Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit</p>	<p>Rregullorja e Procedurave të Auditimit:</p> <p>B.Zeneli, B.Zeqiri, M.Berdo, N.Nako</p>
<p>Urdhër nr. 47, Datë 31.03.2020</p>	<p>Për ngritjen e grupit të punës për referimin e veprave penale në prokurori dhe përmirësimin e Manualit të Auditimit të Mashtrimit & Korrupsionit</p>	<p>Manuali i Auditimit të Mashtrimit & Korrupsionit:</p> <p>K.Sokoli, Gj.Peci, Q.Cibaku, Gj.Ndrejaj, R.Xhaja, E.Elezi.</p>



ANGAZHIMET E NJËKOHËSHME GJATË PERIUDHËS SË DISTANCIMIT SOCIAL NGA CONID-19, DUKE KONTRIBUAR ME MBI 65 SHKRIME, ARTIKUJ, PERKTHIME DHE SHPERNDARJE TE OPINIONEVE, ETJ:

Artikuj të shkruar dhe botuar nga stafi i KLSH gjatë periudhës së pandemisë (Mars- Prill 2020).

Titulli	Autori	Gazeta	Faqe	Data
Suksesi i rimëkëmbjes varet nga të gjithë Ne	Bujar Leskaj	Panorama /Sot/ Mapo/ Telegraf	online	10.04.2020
Rimbursimi dhe kontrolli tatimor	Elida Kocani	Sot	16	13.03.2020
Analiza vjetore e KLSH-së: Mes Kosovës, Petro Markos, librit dhe Prokurorit të Përgjithshëm	Redi Ahmetllari	Mapo	online	19.03.2020
Te punuarit nga shtepia nje asset teknologjik I pavleresuar ne shoqerine tone	Benard Haka	Panorama	online	20.03.2020
Auditimi i “Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, si sfidë për përmirësimin e situatës	Genc Koka	Sot	online	22.03.2020
KLSH dhe Zhvillimi Rajonal	Xhaferr Xhoxhaj	Sot	online	23.03.2020
Roli i KLSH-së në Zhvillimin e Qëndrueshëm të Vëndit	Sali Agaj	Sot	online	24.03.2020
A jemi ne prag ten je ekonomie jo KESH	Eriola Hoxha	Mapo	online	25.03.2020

Projekti i auditimeve me SECO-n dhe IDI-n: Dobi e shumëfishtë për ne	Bujar Leskaj	Sot	online	30.03.2020
Siguria Ushqimore në Shqipëri, në fokus të auditimeve të KLSH-së	Agron Opari	Mapo	online	31.03.2020
Koronavirusi dhe efektet e tij	Aulent Guri	Sot	online	01.04.2020
“Anjeza nuk u zgjua”, Artur Shehu: Një roman që nuk të lëshon deri në fund dhe nuk të hiqet nga mendja	Artur Shehu	Panorama	online	01.04.2020
Një filozofi e re pune	Rejdi Zeneli	Sot	online	03.04.2020
Te jetosh ne kohet e ndryshimit	Vullnet Karafilaj	Mapo	online	06.04.2020
Pandemia e COVID-19: Ndikimi në ekonomi dhe roli i KLSH	Alfonc Gabili	Sot	online	06.04.2020
Koronavirusi dhe paralajmërimet profetike të Zhak Atali (Jacques Attali)	Irena Islami	Panorama	online	06.04.2020
Si te punojme te sigurte nga shtepia	Meald Habazaj	Mapo	online	07.04.2020
Rëndësia e frontit të dytë të luftës me koronavirusin	Amantja Patozi	Sot	online	07.04.2020
Transparenca me sistemet, të dhënat si mjet kontrolli dhe përmirësimi	Edlira Cukalla	Mapo	online	07.04.2020
KLSH dhe sfida e te ardhurave vendore	Aluzh Zace	Telegraf	online	07.04.2020
Menaxhimi i buxhetit të 2020 nga efektet e COVID-19, parë nga këndvështrimi i audituesit të KLSH-së	Brikena Janina	Mapo	online	09.04.2020

Perspektivat e ekonomisë nën ndikimin e COVID-19	Yllka Pulashi	Panorama	online	09.04.2020
Si po e ndryshon teknologjia auditimin	Aldo Kita	Mapo	online	13.04.2020
KLSH dhe sfida për përmirësimin e prokurimeve publike, mbetet prioritet për sot dhe në të ardhmen.	Vladimir Rizvani	Sot	online	13.04.2020
“GAO, NIK dhe leksionet e Dodaros”, një libër i Kryetarit Leskaj që plotëson bibliotekën shqiptare të publicistikës	Redi Ahmetllari	Sot Mapo	online	15.04.2020
Si mund të kontribuojnë SAIt në luftën ndaj dezinformimit	Redina Karapici	Mapo	online	16.04.2020
Vetëqeverisja Vendore përballë COVID-19	Gert Hekurani	Sot	online	17.04.2020
Ringritja ekonomike e vendit vetëm përmes një modeli shqiptar	Manjola Naco	Panorama	online	18.04.2020
Lidhja e Covid 19 me mjedisin dhe ndryshimet klimatike - Kujdesi gjatë hapave për dalje nga kriza shëndetësore, ekonomike e mjedisore	Kejda Muca	Sot	online	18.04.2020
Sfidat e auditimit në distancë	Jorida Zhegu	Mapo	online	18.04.2020
Komisioni Europian, korniza e Prokurimit Publik në lidhje me krizën COVID-19	Erald Kojku	Standard	online	18.04.2020
COVID-19 dhe Shërbimi i Urgjencës Kombëtare në këndvështrimin e pacientit auditues.	Mimoza Bedini	Sot	online	19.04.2020
“Energjia e Qëndrueshme dhe e Ardhmja”	Ermira Vojka	Mapo	online	19.04.2020
Covid-19 dhe dehumanizmi	Melina Kabo	Panorama	online	22.04.2020

Institucionet publike konsiderojnë kontrolle të reja për t'u përgatitur për rregullin e auditimit.	Klara Frangaj	Sot	online	22.04.2020
“Ekonomia e pandemisë koronavirus”	Klevis Kule	Mapo	online	21.04.2020
<u>Tërmeti i fund vitit 2019 dhe pandemia e Covid-19, dy fatkeqësi natyrore ekstreme, sa të përgatitur e gjetën Shqipërinë?</u>	Valbona Ballgjini	Sot	print	22.04.2020
IMPAKTI NEGATIV I COVID-19 MBI FËMIJËT	Mariana Lako	Mapo	print	24.04.2020
<u>Pesë strategji të prokurimit në drejtimin e krizës covid-19 nga e gjithë bota</u>	Erjola Mecaj	Sot	print	24.04.2020
<u>Lidhja e marrëdhënieve të punës dhe dëmshpërblimet për largim nga puna një problem në Shoqëritë Aksionare me kapital 100% shtetëror.</u>	Angjela Nesturi	Sot	print	25.04.2020
<u>“50 Vjet - Dita e Tokës”</u>	Ermira Vojka	Mapo	print	25.04.2020

Përkthime të realizuar nga stafi i KLSH gjatë muajve mars- prill 2020

1.	Largëpmësia dhe Auditimi: Integrimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në punën audituese.	Alma Shehu
2.	Audituesit e së ardhmes - cilat janë aftësi e nevojshme në një epokë dixhitale?	Alma Shehu
3.	Ngritje e kapaciteteve, dixhitalizim dhe mbrojtje e mjedisit në të njëjtën kohë? Ndryshimi i metodologjisë për sigurimin e të dhënave.	Alma Shehu
4.	Inteligjenca emocionale	Altin Dinaj
5.	Ndikimi pozitiv i koronavirusit në mjedis!	Altin Dinaj
6.	Ekonomia normale nuk do të kthehet më kurrë	Angjela Nesturi
7.	Shkencat kompjuterike kundër COVID-19	Bledi Dervishaj
8.	Çfarë kontributi mund të sjellë auditimi i sektorit publik në garantimin e shoqërive etike dhe transparente?	Delor Prosi
9.	Përgatitja e sistemeve qeveritare të menaxhimit financiar ndaj COVID-19	Enejda Seraj
10.	Të dhënat: çelësi i një auditimi më eficient dhe më efektiv	Elsona Papadhima
11.	(ISAM) Modeli i Auditimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) nga IDI	Erieta Kellici
12.	COVID-19 Në të Gjithë Botën: Ndikimi i Pandemisë në Ekonomi dhe Tregje	Ervina Basha
13.	Në samitin e prillit, BE-ja luan gjithçka	Gert Hekurani
14.	Kriza e koronavirusit: implikimet në raportime dhe auditim	Marjus Hajro
15.	Çdo gjë është e kontrolluar.Shteti në kohën e Covid-19	Megi Kurushi
16.	Rimëkëmbja nga kriza e COVID-19 duhet të çojë në një ekonomi ndryshe”	Megi Peza
17.	Impakti Covid-19 në ekonominë botërore.	Miranda Haxhia
18.	Pandemia dhe politikat ekonomike	Rezart Golemaj
19.	Ndikimi i pandemisë së COVID-19 në ekonominë globale – Faktet dhe Statistikat	Semiram Jakupi
20.	Impakti I Koronavirusit në Raportimin Financiar dhe në Konsideratat e Audituesve	Skender Hajdari

21.	Mënyrat se si teknologjia mund të na ndihmojë në reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe disa praktika të mira në botë.	Benard Haka
22.	<i>Pesë strategji të prokurimit në drejtimin e krizës covid-19 nga e gjithë bota</i>	Eriola Mecaj
23.	<u>A do "të vdesë" Ekonomia jonë nga Coronavirus?</u>	Anesti Gjika
24.	<u>Kriza prej COVID-19 i kthen audituesit drejt teknologjive te reja</u>	Rodjon Alimerkaj

TË TJERA:

- Gazeta Online, “Auditimi për qytetarin”, e cila nga 8 faqe po botohet në 12 faqe. Nr. 14 (3), Mars 2020 dhe nr.15 (4), Prill 2020;**
- U përgatit më 31 Mars 2020, Raporti i Performancës së KLSH për vitin 2019;**
- Buletini nr. 1/2020, ku u përfshinë auditimet Janar-Mars 2020**

PËRMBYLLËSE:

Jo pak herë është nënvizuar nga Kryetari i KLSH që, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, trajnimet si elemente të kualifikimit profesional, janë jo thjeshtë e vetëm një indikator për vlerësimin e performancës 6-mujore dhe vjetore të çdo punonjësi, por edhe një Standard Auditimi i njohur, i pranuar dhe i detyrueshëm për zbatim.

Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit përditëson informacionet dhe databasen mbi progresin e trajnimit në vijimësi dhe sjell në vëmendje se, nevoja për trajnim është pjesë e pandarë e koshiençës së një audituesi të ditur, e cila në analizë të fundit përkthehet në kompetencë profesionale të shtuar dhe në rritjen e produktivitetit të gjithsecilit në KLSH.

Në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022 është theksuar se kapitali human- audituesit, mbeten aset më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm

për KLSH-në duke konsideruar që sukcesi në përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave të saj varet në mënyrë të ndjeshme nga të krijuarit të një trupe auditimi kompetente dhe të mirëtrajnuar. Në këtë kontekst, politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, të KLSH përfshijnë nëntë elementët e përmendur në zbatimin e udhërrëfyesit brenda Kontrollit të Cilësisë për SAI-t, ISSAI 40, duke i dhënë rëndësinë e duhur cilësisë dhe angazhimit të KLSH ndaj parimeve etike. Nëpërmjet këtyre elementeve theksohet domosdoshmëria e kulturës së edukimit të vazhdueshëm nga audituesit.

Nëpërmjet politikës së edukimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional KLSH synon të:

- Sigurojë që stafi auditues të zotërojë aftësitë dhe dijet e kërkuara për të realizuar me profesionalizëm çdo aspekt që mund të përballen gjatë punës audituese.
- Aplikojë sistemin e trajnimit të vazhdueshëm të hartuar në përputhje me nevojat individuale të audituesit në mënyrë që të reflektojë nga njëra anë nevojat specifike të individit për njohuri specifike gjatë gjithë jetës,
- Hartojë dhe ndjekë planin e zhvillimit profesional të gjithsecilit sipas kërkesave të sintetizuara në objektivat specifike të Programit Vjetor të Trajnimit
- Realizojë mesatarisht i 25 ditë trajnimi në vit për çdo punonjës së institucionit suprem të auditimit, duke matur njëkohësisht impaktin e këtij sistemi në përfomancën e punës audituese.
- Vendosë një sistemi motivimi që do të ketë për qëllim krijimin e një lidhjeje të ngushtë ndërmjet audituesve dhe institucionit nëpërmjet aktiviteteve të trajnimit intensiv të parashikuara dhe që zhvillohen në KLSH. Për këtë qëllim implementimi i dokumentit të Politikave të Burimeve Njerëzore të KLSH-së përbën instrumentin kryesor për promovimin e vlerave profesionale të audituesve nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm, pasi bazohet në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të vlerave.

Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit

Tiranë, më 24 Prill 2020